

**Objekti: Ftesë për vaksinimin kundër virusit të papiloma virus (HPV) për parandalimin e kancerit në qafën e mitrës**

*Të dashur prindër,*

Ju kemi rezervuar një takim për ti ofruar vajzës tuaj vaksinën kundër virusit të Papilomës njerëzore (HPV).

Takimi për kryerjen e dozës së \_\_\_\_\_ të vaksinës, është prenotuar për datën \_\_\_\_\_ në orën \_\_\_\_\_ pranë qendrës \_\_\_\_\_ vaksinore që gjendet në \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_. Në rast se nuk jeni të disponueshëm në këtë datë, ose për informacione të mëtejshme, jeni të lutur të telefononi në numrin \_\_\_\_\_.

E mitura (minorene) duhet të jetë e shoqëruar nga njëri prind. Nëse prindi nuk mund të jetë i pranishëm mund të delegojë me shkrim një person si zëvendësues. Në letrën e delegimit që duhet të jetë e firmosur nga prindi, duhet të jenë të shkruara emri dhe mbiemri i personit që shoqëron të miturën. Gjithashtu duhet të bashkangjitet fotokopja e dokumentit të identitetit të prindit. Kujtohuni gjithashtu të sillni librezën e vaksinimeve.

Nëse vajza juaj ka kryer vaksinimin në një tjetër qendër vaksinore, ju lutemi të komunikoni në këtë qendër datën e vaksinimit për të kryer kështu regjistrimin në skedën personale.

**Vaksinimi është një veprim i ndërgjegjshëm, në interes të shëndetit të vajzës tuaj, përfitojmë nga rasti për t'ju dhënë disa informacione.**

Tumori i qafës së mitrës, që cdo vit godet në Itali mijëra gra, shkaktohet nga një virus shumë i përhapur, papiloma virus njerëzor, (HPV).

Tipet 16 dhe 18 të këtij virusi (më të përhapurit dhe më të rrezikshmit), janë në fakt të aftë të provokojnë të çara, që në qoftë se nuk dallohen në kohë dhe nuk kurohen, mund të shkaktojnë infeksionin që është përgjegjës për tumorin e qafës së mitrës.

Sot, kundër papiloma virus, që haset kryesisht menjëherë pas fillimit të aktivitetit seksual, nuk ekziston asnjë lloj kure; vaksinimi pra paraqet një armë të fortë për parandalimin e infeksionit. Për këtë Rajoni i Toskanës nëpërmjet Shërbimit Shëndetësor Rajonal, i ofron të gjitha adoleshenteve me rezidencë në Toskanë, duke filluar nga 11 vjeç mundësinë e **vaksinimit gratis**.

Vaksina është veçanërisht avantazhuese sepse:

- Siguron një mbrojtje efikase përpara një infektimi të mundshëm me virusin HPV që merret zakonisht menjëherë pas fillimit të aktivitetit seksual dhe varet dhe nga sjelljet në jetën seksuale personale.
- Reagimi i sistemit imunitar në vitin e 12 të jetës është më i fortë sesa tek vajzat dhe gratë në faza të tjera të moshës.

Të presësh "akoma ndonjë vit" sepse "vajza ime është akoma e vogël" mund të paraqesë një gabim sepse kështu humbet mundësia për të patur një përgjigje të shkëlqyer nga vaksinimi dhe për të qënë të mbrojtur të sigurt përpara çdo lloj mundësie infektimi.

Përpara kryerjes së vaksinimit kundër HPV, kontrolli periodik (Pap-test) ka paraqitur të vetmin instrument në dispozicion për parandalimin, që ka lejuar gjithashtu të dallohen në mënyrë të hershme të çarat e shkaktuara nga papilomavirus (HPV). Sot, kombinimi **vaksinim dhe test** paraqet mënyrën më efikase dhe komplete për parandalimin e kancerit në qafën e mitrës.

Në fakt theksojmë, vakcina punon në krah, por nuk zëvendëson kontrollin periodik (Pap-test) aktualisht i rekomanduar çdo 3 vjet, për gratë nga mosha 25 deri në 64 vjeç.

Vaksina është e sigurt. Efekte të pakta anësore që mund të manifestohen pas vaksinimit (fryrje dhe skuqje në zonën e injektimit, dhimbje dhe nganjehere dhe pak temperaturë) zhduken pa asnjë lloj pasoje brenda pak ditëve.

Vaksinimi shtyhet në rast se vajza është e sëmurë me temperaturë.

Vaksinimi është i pakëshillueshëm për gratë shtatzana dhe kush vuan nga alergjitë nga ilaçet, ose nga përbërësit e vaksinës, duhet t'ja komunikojë personelit shëndetësor.

Për informacione të mëtejshme mund ti drejtoheni mjekut ose pediatrit të familjes, qendrës vaksinuese, ose Higjenës Publike të Ndërrmarjes Shëndetësore.

Lajme më të gjera i gjeni dhe në sitin e mëposhtëm:

<http://www.regione.toscana.it/iointantomivaccino>